



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 23 dt.14.02.1996

Në mbledhjen e **Këshillit Bashkiak**, dt.14.02.1996, u shqyrtua dhe u shpërndanë apartamentet e godinës pranë ish **Hotel “Pezës”** si dhe u përcaktuan masat për individët që nuk përfituan.

Për rrjedhim **Këshilli Bashkiak** :

VENDOSI

1. **Këshilli Bashkiak** i propozon Këshillit të Ministrave që për problemet e vështira të qytetarëve të tjerë, pronarët në zonën e mësipërme dhe të pastrehuar të trajtohen me përparësi. Për këtë **Këshilli Bashkiak** ka mendimin dhe janë të gjitha kushtet të vazhdojë ndërtimi në këtë truall(aktualisht i lirë) sipas projektit ekzistues dhe domosdoshmërisht të strehoen pjesa e ish banorëve të cilët disponojnë kontratat konform legjislacionit dhe ish pronarët që nuk përfituan nga shpërndarja e pallatit të mësipërm.
2. Për realizimin e ndërtimit të pallatit dhe të planit urbanistik të miratuar t'i propozohet **Kryetarit të Këshillit të Ministrave** për kompesim(ose shpronësim) e kësaj zone që preket nga zbatimi i gen-planit të paraqitur.
3. Me propozim të **Kryetarit të Bashkisë të Rrethit të Tiranës Z.Sali Kelmendi** dhe me miratim të **Këshillit**

Bashkiak vendosi që pronarëve të truallit ku është vendosur godina, tu njihet e drejta e parablerjes edhe të objekteve publike(banjove)për këtë **Këshilli Bashkiak** porositi **Komisionin e Kthimit e Kompesimit të Pronave** të kryejë procedurat e nevojshme.

KRYETARI

BESNIK PETRELA